



**DEA** OPEN AIR  
INTERNATIONAL  
FILM FESTIVAL  
27 Aug to 02 Sept 2017

## **Edicioni i Katërt ...**

**Në datat 27 Gusht deri më 2 Shtator 2017, Festivali Ndërkombëtar i Filmit Dea Open Air do të zhvillojë edicionin e tij të katërt. Festivali vijon traditën e të qenit vizitor në stolinë e rivierës shqiptare, Sarandë.**



**Shfaqjet Open Air do të organizohen në Kinema Limani dhe Kinema Bougainville. Në Kinema Limani organizohet Ceremonia zyrtare e Hapjes së Edicionit IV të Dea Open Air Festival Sarandë – 2017 dhe ofrohen dy programet kryesore të festivalit: programi i Filmit me Metrazh të Gjatë dhe programi i Filmit të Shkurtër.**



**Në Kinema Bougainville organizohet për herë të parë programi “Miq të Kinemasë”, me shfaqje speciale filmash jashtë konkurimit si edhe Ceremonia e Ndarjes së Çmimeve të Edicionit IV të Dea Open Air Festival Sarandë – 2017.**

**Numri i aplikantëve të DEA OPEN AIR ka ardhur në rritje nga viti në vit. Edhe edicioni i sivjetëm konfirmon të njëjtën tendencë rritëse.**



**Të gjithë pjesëmarrësit kanë aplikuar në platformat Film Freeway dhe Festhome ose në rrugë të drejtpërdrejtë në adresën e Festivalit.**

**Aplikuesit vijnë jo vetëm nga vendet evropiane, por edhe më gjerë, duke i dhënë aplikimit – si në edicionet paraardhëse – gjeografi ndërkontinentale.**

**Filmat e paraqitur dhe autorët që marrin pjesë në konkurrim i janë nënshtruar fillimisht seleksionimit paraprak të komisioneve ndërkombëtare, të mbyllur në fund të muajit Mars.**

**Në garë për Çmimet DEA komisionet e përzgjedhjes paraprake kanë menduar të përfshijnë sivjet 6 filma të gjatë për Seksionin e filmit me metrazh të plotë ose konkurimin kryesor si dhe 35 filma në Seksionin e filmit të shkurtër. Vetë filmi i shkurtër ofrohet këtë vit në dy nënkategori: konkurim ndërkombëtar dhe konkurim studentor. Kategorizimi reflekton natyrën e krijimtarisë dhe profilin e autorëve të tyre.**



**Sfidë e Edicionit të Katërt të DEA OPEN AIR mbetet afrimi i audiencave me filmin. Për këtë qëllim krahas promovimit të aktivitetit dhe produktit filmik në qytet dhe në media, DEA në bashkëpunim me Neptun Saranda do të organizojë dhe një shorte, në fund të të cilit do ndahet një çmim. Pjesëtarët e publikut do të pajisen në hyrje të kinemasë me një formular vlerësimi për filmin, të cilin do ta dorëzojnë kur të largohen. Formularët e mbledhur do të shërbejnë si bileta për shorteun dhe si bazë vlerësimi për Çmimin e publikut.**

**Edicionin e Katërt të DEA International Film Festival e mbështet Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë, të cilat së bashku me Bashkinë e Sarandës krijojnë atmosferën e nevojshme mikpritëse për prurjet artistike dhe kontributet qytetare nga e gjithë bota.**



**Specialistët e kinemasë, drejtorët e disa festivaleve të tjera evropiane të filmit, por dhe aktorët, regjisorët, producentët dhe gazetarët e ftuar i japin aktivitetit gjallërinë dhe komunikimin shumëdimensional, që kinemaja gjithnjë premtan dhe realizon.**

**Zyra e shtypit  
DEA OPEN AIR**

